



Pranuar / Dorezuar Prilbena / Predato Received / Deliverty	15.03.2022	2	viti god year
Organ /Njësia Organ /Jednica Org./Unit	Nr Prot Rr Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKIMSHIK	1397/2022		1/5

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.96/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi-kryetare, Arben Mehmeti dhe Jeton Koca-anëtarë, me Rushit Kajtazi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën A.nr.96/2022 të datës 04.02.2022 të parashtruar nga ankuesi [redacted] të cilin me autorizim e përfaqëson [redacted] avokat nga Prishtina, kundër organit të punësimit/Ministria e Punëve të Jashtme dhe Γ'asporës, në çështjen juridik "kërkesë nga marrëdhënia e punës", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nenparagrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nenparagrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim me datë 15.03.2022, mori këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet si e pabazuar ankesa A.nr.96/2022 e datës 04.02.2022, e parashtruar nga ankuesi [redacted]

II. Mbetet në fuqi Vendimi Nr.Ref:25/2022 i datës 24.01.2022, i Zëvendësuesit të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës.

A r s y e t i m

Ankuesi [redacted] i punësuar në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, përmes përfaqësuesit me autorizim, me datë 04.02.2022 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, kundër Vendimit Nr.Ref:25/2022 të datës 24.01.2022 të Zëvendësuesit të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, me pretendimet ankimore se vendimi i kundërshtuar është i pa drejtë, kontradiktor dhe i pabazuar në legjislacionin në fuqi.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (tutje referuar Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullosës Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 10.02.2022, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës (tutje referuar

MPJD). Ndërsa me datë 18.02.2022, Këshilli ka pranuar përgjigjen në ankesë si dhe shkresat lidhur me lëndën.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, me qëllim të vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike dhe bazës juridike, për marrjen e vendimit meritör ka administruar këto prova: Ankesën A.nr.96/2022 të datës 04.02.2022, të parashtruar nga ankuesja me numër protokolli 534/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Autorizimin e datës 28.01.2022; Akt Emërimit me numër të 176 të datës 23.05.2016; Akt Emërimit e numër 176 të datës 11.05.2017; Vendimin me nr.ref:71/2021 të datës 22.03.2022 të Zëvendësuesit të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës; Vendimin me Nr.Ref: 153/2017 të datës 23.06.2017 të Ministrit të Ministrisë së Punëve të Jashtme; Dekretin me numër 50/2019 të datës 12.02.2019 të Presidentit të Republikës së Kosovës; Dekretin me numër 44/2019 të datës 24.06.2020 të Presidentit të Republikës së Kosovës; Vendimin Nr.ref: 53/2020 të datës 30.06.2020, për sistemim të përkohshëm të ankuesit; Vendimin me Nr.ref: 54/2020 të datës 30.06.2020 për pezullimin e dakorduar të ankuesit; Vendimin me Nr.ref 71/2021 të datës 22.03.2021 për lejimin e pushimit pa pagesë të ankuesit; Vendimin Nr. Ref. 25/2022 të datës 24.01.2022, për shfuqizimin e Vendimit nr.ref.53/2020 të datës 30.06.2020 dhe shfuqizimit të pjesërisht të vendimit nr.ref. 71/2021 të datës 22.03.2021; Përgjigjen në ankesë me numër protokolli 861/2022 të datës 18.02.2022; Kërkesën e datës 19.03.2021 për pezullimin e dakorduar të ankuesit; e-maili i datës 18.2.2021 nga menaxheri i Personelit të MPJD për KPMSHC, E- maili i datës 11.02.2022 nga Hamdi Berbatovci për Vigan Berisha; Raporti Final i Auditimi me numër protokolli 2895 i datës 03.11.2021 lidhur me menaxhimin e Burimeve Njerëzore të MPJD.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi ka shqyrtuar dhe analizuar shkresat e lëndës, konstatoi së janë të pabazuara pretendimet ankimore të ankuesit, *sepse*,

Nga administrimi i provave të lëndës, Kolegji ka gjetur së ankuesi sipas Akt emërimit me Nr.176 të datës 25.03.2016, është emëruar në pozitën e punës *Zyrtar i Lartë për Shtete dhe Organizata Ndërkombëtare/Evropë Qendrore* në Departamentin për Evropë dhe BE, në kuadër të Ministrisë së Punëve të Jashtme. I njëjti me Vendimin me Nr.Ref:153/2017 të datës 23.06.2017 të Ministrit të MPJ-së, i është caktuar grada diplomatike *Ministër Këshilltar*.

Me Vendimin Nr.Ref:726/2018 të datës 22.11.2018 të Ministrit të MPJ-së, ankuesi ishte emëruar i ngarkuar me punë të përkohshëm në misionin diplomatik të Republikës së Kosovës në Bangkok/Mbretëria e Tajlandës, ndërsa, me Dekretin Nr.50/2019 të datës 12.02.2019 të Presidentit të Republikës së Kosovës ankuesi emërohet Ambasador/Shef i Misionit Diplomatik të Republikës së Kosovës në Mbretërinë e Tajlandës. Tutje me Dekretin Nr.44/2020 të datës 24.06.2020 të Presidentit të Republikës së Kosovës, urdhërohet tërheqja e ankuesit nga pozita e Ambasadorit/Shefit të Misionit Diplomatik të Republikës së Kosovës në Mbretërinë e Tajlandës.

Pas kthimit nga misioni, me Vendimin e U.d. Sekretarit të Përgjithshëm Nr.Ref: 53/2020 të datës 30.06.2020, ankuesi është sistemuar përkohësisht në pozitën *Udhëheqës i Divizionit për Prokurim*. Në të njëjtën datë përmes Vendimit Nr.54/2020 të U.d. Sekretarit të Përgjithshëm, është lejuar pezullimi i dakorduar i ankuesit për shkak të emërimit të tij Zëvendësministër i Punëve të Jashtme dhe Diasporës.

Sipas kërkesës së ankuesit, me Vendimin Nr.Ref:71/2021 të datës 22.03.2021 të Sekretarit të Përgjithshëm, ankuesit është lejuar pushimin pa pagesë për arsye të mbarimit të studimeve të doktoratës në kohëzgjatje prej një (1) viti, duke filluar nga data 23.03.2021 deri me datë 23.03.2022.

Zëvendësuesi i Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës më datë 24.01.2022 ka nxjerr Vendimin Nr.Ref: 25/2022 të datës 24.01.2022, me të cilin ka shfuqizuar Vendimin Nr.Ref: 53/2020 të datës 30.06.2020 duke përcaktuar se ankuesi pas përfundimit të pushimit pa pagesë të aprovuar sipas Vendimit Nr.Ref.71/2021 të datës 22.03.2021, do të sistemohet në pozitën e punës sipas Akt Emërimit Nr.176 të datës 23.05.2016.

Ankuesi i pakënaqur me Vendimin me Nr.Ref:71/2021 të datës 22.03.2021, brenda afatit ligjor ushtron ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, me pretendimet ankimore se vendimi i kundërshtuar është i pa drejtë, kontradiktor dhe i pabazuar në legjislacionin në fuqi, me tej shton se bazuar në nenin 4 paragrafin 1 dhe paragrafin 2 nën paragrafi 2.5 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë si dhe nenin 23 paragrafin 1 të Ligjit Nr.03/L-122 për Shërbimin e Jashtëm, çështja e transferimit lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë janë kompetencë e plotë e ministrit të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës .Kërkon që Këshilli ta aprovoj ankesën, ta anuloj Vendimin Nr.Ref.25/2022 të datës 24.01.2022 të Zëvendësuesit të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, si dhe të obligoj të njëjtin që ankuesin ta kthej në pozitën e punës sipas Vendimit Nr.Ref:53/2020 të datës 30.06.2020.

Organi i punësimit në përgjigjen në ankesë pretendon se sistemimi i përkohshëm i ankuesit sipas Vendimit Nr.Ref:53/2020 të datës 30.06.2020, është bërë në kundërshtim me nenin 26, 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, andaj meqenëse Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës nuk ka zhvilluar procedurë të avancimit në detyrë për ankuesin, ashtu siç përcaktohet me ligjin e aplikueshëm të Shërbimit Civil (Nr. 03/L-149) si dhe Rregulloren nr. 21/2012 për Avancimin në Karrierë të Nëpunësve Civil (e aplikueshme në kohën e avancimit), por i njëjti sistemohet direkt me Vendim të Sekretarit të Përgjithshëm në pozitë të Udhëheqësit të Divizionit, përkundër që kishte Akt Emërim të "Zyrtarit të Lartë", para shkuarjes në mision.

Bazuar në vlerësimin e shkresave të lëndës Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave konstatoi se në kohën e nxjerrjes se Vendimit Nr.Ref: 53/2020 të datës 30.06.2020, për sistemimin e përkohshëm të ankuesit në pozitën *Udhëheqës i Divizionit për Prokurim*, pas kthimit të tij nga misioni diplomatik, ka qenë në zbatim Ligji Nr.04/L-149 për Shërbimin Civil të Kosovës, kështu që Kolegji lidhur me trajtimin e çështjes në shqyrtim, ju referua dispozitave të Ligjit Nr.04/L-149 për Shërbimin Civilë si dhe legjislacionit në fuqi për Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Kosovës.

Ligji Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil me nenin 3 paragrafi 4 kishte përcaktuar se: *Personeli diplomatik dhe konsullor, si dhe personeli administrativ i dërguar jashtë vendit ose i punësuar në Ministrinë e Punëve të Jashtme të Kosovës, është pjesë e Shërbimit Civil të Kosovës dhe i nënshtrohet këtij ligji dhe legjislacionit përkatës në fuqi*, kurse Ligji Nr.03/L-044 për Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Shërbimin Diplomatik, gjegjësisht neni 8 përcakton se: *Anëtarët e Shërbimit Diplomatik të Kosovës, përveç të emëruarve politik, janë pjesë e Shërbimit Civil të Kosovës dhe personeli i tij i nënshtrohet të njëjtave paga, kërkesa dhe kushte të punës, përveç nëse parashihet ndryshe me këtë ligj ose me ligje tjera ose akte nënligjore me qëllim të sigurimit të mbarëvajtjes efektive të punës së ambasadave dhe misioneve ose zyrave tjera jashtë Kosovë, e mbi këtë bazë ligjore, Kolegji ka konstatuar se në mungesë të akteve të veçanta të Ministrisë së Punëve të Jashtme PJD-së lidhur me sistemimin dhe ri caktimin e nëpunësve civil pas përfundimit të mandatit diplomatik, do të aplikohen dispozita e legjislacionit të aplikueshëm për shërbimin civil.*

Përkritazi me shqyrtimin e pretendimeve ankimore të ngritura në ankesë, Kolegji ka analizuar dispozitat e Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil, konkretisht nenin 26 me të cilin është përcaktuar

se: 1. Avancimi në karrierë në shërbimin civil zhvillohet përmes avancimit nga një kategori më e ulët funksionale në një kategori më të lartë, ose nga një gradë më e ulët në një gradë më të lartë brenda të njëjtës kategori funksionale. 2. Qasja, përmes gradimit, në nivele më të larta të hierarkisë funksionale në Shërbimin Civil të Kosovës bazohet ekskluzivisht në meritë, aftësi dhe përvojë, dhe është e hapur për të gjithë nëpunësit civilë të kualifikuar përmes konkurrencës, pa cenuar parimet e mosdiskriminimit të përcaktuara me këtë ligj dhe me Ligjin Kundër Diskriminimit. 3. Çdo pranim, avancim, punësim i cili është në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji nuk është i lejueshëm. 4. Emërimi i drejtpërdrejtë në pozita të lira, në kundërshtim me parimin e meritës dhe procedurat e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, nuk është i lejueshëm.

Ndërlidhur si me lartë, neni 27 i Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil parasheh se: 1. Avancimi nga një pozitë më e ulët në pozitë më të lartë funksionale ose nga një gradë më e ulët në një gradë më të lartë brenda pozitës funksionale lejohet në bazë të: 1.1. disponueshmërisë së pozitave të lira; 1.2. plotësimi të të gjitha kushteve të caktuara për atë pozitë; 1.3. kalimit të kohës së caktuar minimale; dhe 1.4. kalimit me sukses të testimit, dëshmimit të meritës, aftësive dhe kompetencës profesionale. 2. Gradimi është i mundur vetëm për nëpunësit civilë të karrierës, të cilët janë të klasifikuar jo me poshtë se dy (2) gradë të punës nga pozita e shpallur e lirë, përveç rasteve kur përcaktohet ndryshe me këtë ligj...”, rrjedhimisht Kolegji duke u bazuar në shkresat e lëndës ka konstatuar së ankuesi me rastin e caktimi të tij që të shërbej në misionin diplomatik ka qenë i emëruar dhe ka ushtruar pozitën e Zyrtarit të Lartë për Shtete dhe Organizata Ndërkombëtare/Europë Qendrore, ndërsa pas kthimit nga misioni diplomatik, i njëjti me Vendimin Nr.Ref:53/2020 të datës 30.06.2020 të U.d. Sekretarit të Përgjithshëm është sistemuar përkohësisht në pozitën Udhëheqës i Divizionit për Prokurim. Kështu që, nisur nga ky konstatim e në kuptim të dispozitave ligjore si me lartë rezulton se sistemimi i ankuesit nga pozita e Zyrtarit të Lartë si pozitë profesionale, në pozitën e Udhëheqësit të Divizionit si pozitë drejtuese e nivelit të ulët, pa zbatim të procedurës së avancimit gjegjësisht të ngritjes në detyrë është në kundërshtim të plotë me dispozitat e nenit 26 dhe 27 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil, përkatësisht çdo avancim i cili është në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji nuk është i lejueshëm.

Po ashtu Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka shqyrtuar ligjshmërinë e vendimit të kundërshtuar me ankesë, edhe në kuptim të dispozitave të nenit 28 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës me të cilin thuhet se: 1. Transferimi i nëpunësve civil mund të bëhet në formë të ricaktimit në vend tjetër të punës dhe si transferim i përkohshëm në detyra tjera. .. 3. Ricaktimi mund të bëhet përmes: 3.1. lëvizjes paralele në një zyrë tjetër në kuadër të organizatës së njëjtë ose në organizatë tjetër në të njëjtën kategori funksionale dhe gradë, brenda administratës qendrore ose komunale; 3.2. rotacionit në një zyrë tjetër në të njëjtën kategori funksionale dhe gradë, por me detyra të tjera; dhe 3.3. lëvizja e përkohshme në një organizatë tjetër jashtë shërbimit civil të Kosovës; 3.4. nëpunësi civil, me pëlqimin e tij/saj dhe në marrëveshje me punëdhënësin, mund t'i nënshtrohen transferimit të përkohshëm në detyra të tjera me qëllim të dërgimit në detyrë të veçantë në një organizatë ndërkombëtare, ndërmarrje publike ose në cilëndo organizatë tjetër publike, për të cilën nevojiten aftësi dhe përvojë e caktuar profesionale, e në kuptim të këtyre dispozitave ligjore, Kolegji konstaton se ricaktimi i përkohshëm i nëpunësit civil nga një pozitë në një pozitë tjetër të punës, mund të bëhet vetëm për ushtrimin e funksioneve të njëjta ose të ndryshme, në të njëjtën kategori funksionale dhe gradë. Andaj, meqenëse sistemi i ankuesit nga pozita e Zyrtarit të Lartë në pozitën e Udhëheqësit të Divizionit nuk është bërë në kategori të njëjtë funksionale, atëherë, Kolegji nisur nga ky konstatim si dhe duke marrë parasysh rrethanat si me lartë vlerëson se janë të pabazuara pretendimet ankimore të ankuesit se Vendimi Nr.Ref:25/2022 të datës 24.01.2022 i Zëvendësuesit të Sekretarit të Përgjithshëm të MPJ, është i pa drejt dhe i nxjerrë me shkelje ligjore.

Në vështrim të nenin 52 paragrafi 1.3 dhe 1.5 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, një vendim i nxjerrë me shkelje të dispozitave procedurale dhe në kundërshtim me

ligjin material është akt i paligjshëm, kështu që pas konstatimit se sistemimi i ankuesit nga pozita e Zyrtarit të Lart për Shtete dhe Organizata Ndërkombëtare në pozitën e Udhëheqësit të Divizionit të Prokurimit është bërë pa respektim të procedurës ligjore, rrjedhë se organi i punësimit me rastin e nxjerrjes së Vendimit Nr.Ref:25/2022 të datës 24.01.2022 ka zbatuar drejtë ligjin material duke vepruar në pajtim me nenin 53 paragrafi 1 dhe nenin 55 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Andaj, duke përmbledhur sa më sipër, Kolegji për Vendosjen dhe Shqyrtimin e Ankesave pas analizimit dhe shqyrtimit të shkresave të lëndës, si dhe duke u bazuar në nenin 132 paragrafi 2 si dhe nenin 18 paragrafi 1 nënparagrafi 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimit.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike:

Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS Lënda me numër A.nr.96/2022

Rushit Kajtazi

Procesribajtës

Ardita Haxhnikaj-Demi

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Përfaqësuesit me autorizim .
- Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës;
- Udhëheqësit të Personelit në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së